



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 359 Prot.

Tiranë, më datë 23.08.2024

VENDIM  
Nr. 314, datë 23.08.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.08.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e projektit “Restaurim banesa Albert Kristo Gjirokastër”, Brenda Kufirit Qendër Historike Gjirokastër me aplikues dhe zhvillues z. **Albert Kristo**, me rekomandimin:
  - Të eliminohen vetratat e xhamit poshtë ballkonit (në katin përdhe);
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI

